



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 508/6 Prot.

Tiranë, më 07.09.2016

V E N D I M

Nr.100, Datë 07.09.2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
ARRSH PROJEKTI “NDËRTIMI I RRUGËS TIRANË-ELBASAN”, MBI
“ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË SË
VEPRIMTARISË EKONOMIKO - FINANCIARE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në ARRSH, Projekti “Ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan”.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm rezulton se, nga ana e Njësisë së Menaxhimit të Projektit nuk janë realizuar rekomandimet si më poshtë:
Nga 12 masa organizative të rekomanduara, nuk janë zbatuar plotësisht dy masa organizative. Nga 4 masa shpërblim dëmi janë realizuar 2, ndërsa dy të tjera pjesërisht. Është zbritur nga certifikatat e punimeve sipas kontratave vlera 412.8 mijë USD, ndërsa nuk janë marrë masa për kërkimin e vlerës 16.8 milionë lekë sipas kontratës së përfunduar “Ndërtimi i Tunelit të Krrabës, si dhe nuk është zbritur vlera 671 mijë USD, për punime të likuiduara dhe të pa

realizuara për kontratat në proces “Sauk-Tuneli i Krrabës” dhe “Tuneli i Krrabës-Elbasan” (trajtuar më hollësisht në faqet 11 deri 20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezulton se, përgjatë një periudhe 19 mujore (periudha mes dy auditimeve) është realizuar vetëm 22 % e punimeve. Duke marrë në konsideratë afatin e përcaktuar në kontratë për përfundimin e veprës për 490 ditë ose 16.3 muaj, progresi i punimeve është shumë i ulët. Shtesa e afatit të përfundimit të punimeve është miratuar nëpërmjet amendamenteve nr. 1, 4 dhe 6 të kontratës, sipas të cilave përfundimi i punimeve është përcaktuar data 12.12.2015. Kontraktori ka dorëzuar kërkesën për kohë shtesë me anë të shkresës nr. 797, datë 08.12.2015. Sipas vlerësimit të supervizorit, data e përfundimit të projektit është 30.09.2016. Deri në momentin e auditimit nuk është marrë asnjë vendim në lidhje me shtesën e afatit kohor të mëtejshëm të kontratës, si nga ana e Njësisë së Menaxhimit të Projektit, ashtu dhe nga ana e Donatorit, Bankës Islamike për Zhvillim. Bazuar në Raportin e Supervizorit në muajin maj 2016, janë zhvilluar takime me prezencë të NjMP, Supervizorit, donatorit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Transportit e Infrastrukturës, është vendosur që 85 % e punimeve të përfundojnë deri në muajin dhjetor 2016 dhe pjesa tjetër deri në muajin mars 2017 (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me Supervizorin, t'i kërkojnë kontraktorit paraqitjen e një grafiku të ri të punimeve, në të cilin të përcaktohet qartë afati i përfundimit të punimeve, me synim përfundimin në një kohë sa më të shpejtë të punimeve në segmentin “Sauk-Tuneli i Krrabës” dhe vënien në eficiencë të plotë të investimit.

Brenda datës 30.09.2016

3. Gjetje nga auditimi:

Kosto e Projektit është rritur me vlera të konsiderueshme krahasuar me parashikimin në marrëveshjen e financimit, për të gjitha segmentet. Rritje më të madhe të kostos ka për segmentin nr. 1, ku deri në momentin e auditimit çmimi i kontratës është rritur me vlerë 26.5 milionë USD, vlerë e cila do të rritet, duke marrë në konsideratë se nuk janë bërë akoma zgjidhjet teknike për seksionet problematike në segmentet 12+000, 13+000 dhe 14+000, për të cilat do të kërkohen fonde shtesë (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori të marrin masat e duhura për minimizimin e kostove të projektit, duke shqyrtuar me përgjegjshmëri propozimet teknike të kontraktorit, ndryshimet e projektit etj., sipas parimit të ekonomikitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Brenda datës 30.09.2016

4. Gjetje nga auditimi:

Projekti origjinal ka rezultuar me mangësi, si pasojë është kërkuar miratimi i shumë ndryshimeve. Pavarësisht mangësive në projektin origjinal, mangësi janë konstatuar edhe në rishikimin e këtij projekti sipas vlerësimit inxhinierik i cili është kërkuar të përmirësohet.

Ndryshime të theksuara nuk ka vetëm për segmentin nr. 1 për edhe për dy segmentet e tjerë të këtij projekti.

Nga Supervizori dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit nuk janë marrë masat e duhura për verifikimin e saktësisë së vizatimeve teknike, sipas parimit të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit. Vetëm për rastin e Usekut të Mulletit, pranohen vizatime të cilat parashikojnë ulje të pjerrësisë së skarpatave, të cilat në vend që të shoqërohen me ulje të masave inxhinierike (ulje e kostos së ndërtimit ankerave, apo mureve me pilota, duke reduktuar koston e ndërtimit), shoqërohen me rritje.

Ndryshimet e projektit origjinal, kanë rritur koston e projektit për zbatimin e punimeve, por dhe të shërbimeve konsulente. Përfshirja e zërave të rinj në zbatimin e punimeve Ndryshimet në projekt ndikojnë negativisht në zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve, mos futjen në funksionim të segmenteve të caktuara të rrugës, siç është rasti i segmentit nr. 1 (Sauk-Tuneli i Krabës), duke mos marrë përfitimet e parashikuara në sasinë dhe kohën e përcaktuar në marrëveshje, thënë ndryshe ndikojnë në arritjen e objektivave të projektit (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

ARRSH dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit të marrin masa për një shqyrtim më të detajuar të projekteve, apo ndryshimeve të tyre, duke zgjedhur alternativa sa më ekonomike dhe eficiente. ARRSH, nëpërmjet Këshillit Teknik, të mos miratojë ndryshimet teknike në parim, por gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të kërkohen projektzbatime të detajuara shoqëruar me analiza tekniko-ekonomike të çmimeve për zërat e rinj që kërkohen të shtohen.

Vazhdimisht

5. Gjetje nga auditimi:

Gjatë zbatimit të punimeve ka shmangie në zbatimin e specifikimeve teknike, si dhe në sasinë e punimeve të cilat certifikohen dhe likuidohen. Edhe në auditimin e mëparshëm janë konstatuar diferenca të mëdha të punimeve të likuiduara krahasuar me ato të realizuara në fakt, të cilat u konstatuan edhe në këtë auditim (megjithëse volumi i punimeve të realizuara në periudhën ndërmjet dy auditiveve është i vogël). Nga ana e Supervizorit nuk bëhen kontrollet e nevojshme, teste dhe matje të punimeve të paraqitura nga Kontraktori si të realizuara. Pavarësisht se këto punime duhet të konsolidohen në certifikatën finale, certifikimi i tyre pa u realizuar akoma është në kundërshtim me Pikën 12.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC dhe krijon risk humbje në rastin e dështimit të kontraktorit për realizimin e kontratës, ndërprerje të kontratës etj. (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit, të rrisë monitorimin nëpërmjet sondazheve të vazhdueshme gjatë realizimit të punimeve, për të siguruar që punimet e certifikuar të jenë në përputhje me sasinë e realizuar në fakt dhe të jenë respektuar specifikimet teknike sipas përcaktimeve në kontratë.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi:

Krahas kostove të tjera të parashikuara në kundërshtim me kontratën për ndërtimin e Usekut të Mulletit dhe Rrëshqitjen e Ibës, është parashikuar edhe rialokimi i shtyllave të tensionit të lartë për Usekun e Mulletit me vlerë 350,000 USD dhe për rrëshqitjen e Ibës me vlerë 200,000 USD. Këto vlera janë përcaktuar si paraprake, pa u bazuar në analiza të detajuara të kostos së realizimit të tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me Supervizorin, t'i kërkojnë Kontraktorit të paraqesë analiza të sakta të çmimeve që kërkojnë për realizimin e rialokimit të shtyllave të tensionit të lartë për Usekun e Mulletit dhe Rrëshqitjen e Ibës, duke bërë rregullimet në preventivat përkatëse.

Brenda datës 30.10.2016

7. Gjetje nga auditimi:

Sipas dokumentacionit të paraqitur, ARRSH është pajisur me “Lejen për ndikimin në mjedis” për ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan, nga Qendra Kombëtare e Licencimit me datë 12.07.2013. Në pikën 3.1, paragrafi 3, të kushteve të kësaj leje përcaktohet: “*Të merren masat teknike për zbutjen e ndikimeve në mjedis të gjeneruara nga operacionet e gërmimit dhe prodhimit të dherave*”.

Nuk janë marrë masa për këtë qëllim për gjithë segmentin rrugor Tiranë-Elbasan, por më të theksuara dhe aktuale problemet mjedisore janë shkaktuar në zonën e Mulletit.

Për hedhjen e dherave nuk janë miratuar vend depozitime dhe nuk është marrë leja përkatëse mjedisore deri me datë 09.06.2016.

Në VNM paraparak nr. 32, datë 09.06.2016, të marrë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, janë miratuar 4 vend depozitime provizore të dherave, 2 nga të cilat në zonën e Lundrës dhe 2 në zonën e Mulletit (trajtuar më hollësisht në faqet 62 deri 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori t'i kërkojnë kontraktorit marrjen e masave përkatëse për eliminimin e ndotjes së mjedisit. Të bëhen studimet përkatëse dhe të kërkojnë leja për depozitim të përhershëm të mbetjeve që rezultojnë nga gërmimet në vende të cilat nuk kanë ndikim negativ në mjedis.

Brenda datës 30.09.2016

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi konstatohet se, nuk janë miratuar zona vend depozitimi bazuar në kriteret mjedisore, por janë miratuar ato zona ku kontraktori ka filluar depozitimin më parë se të bëhej kërkesa për vend depozitimi.

Kështu, bazuar në zonën e miratuar në Fshatin Lundër me sipërfaqe 36938 m², konstatohet se kjo zonë është ngjitur me përroin, pra nuk është në distancë më të madhe se 100 m, në kundërshtim me vetë përcaktimet e lejes mjedisore Pika 3.9, Par. 3, ku përcaktohet: “*Ndalohet ndërtimi i vend depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë, lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor*”. Bazuar sa më sipër, depozitimi i dherave në këtë zonë është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi (trajtuar më hollësisht në faqet 62 deri 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori të kërkojnë nga organet kompetente revokimin e lejes mjedisore për venddepozitimin në Fshatin Lundër me sipërfaqe 36938 m², si dhe të merren masa për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara në këtë zonë.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi:

Nuk janë marrë masa për mbjelljen e pemëve sipas sipërfaqes së shpyllëzuar nga zbatimi i punimeve, në kundërshtim me Kushtet e Lejes Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (datë 23.07.2013), pika 3.1, paragrafi 11, ku përcaktohet, “*Në rast prerje pemësh dhe dëmtimi i sipërfaqeve pyjore, në marrëveshje me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të rrethit përkatës, të kryhet rimbjellja e tyre dhe të ruhet raporti “dëmto 1 mbill 3”* (trajtuar më hollësisht në faqet 62 deri 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

ARRSH dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, të marrin masat e duhura në përputhje me legjislacionin në fuqi, për mbjelljen e pemëve në masën e përcaktuar në Kushtet e Lejes Mjedisore.

Gjatë zbatimit të kontratës

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik me vlerë 2,411,159 USD. Në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

-Nga verifikimet e punimeve që po realizohen në Usekun e Mulletit sipas urdhër ndryshimit të pa miratuar ende përfundimisht rezulton se, disa nga punimet e realizuara nga kontraktori në Kodrën e Mulletit, sipas projektit të ndryshuar nga vetë Kontraktori (nëpërmjet vlerësimit Inxhinierik) kanë rezultuar difekte, me rrezik shembje të skarpateve. Këto punime duhet të përsëriten si pasojë e uljes së pjerrësisë së skarpateve dhe rindërtimit të masave mbrojtëse të tyre. Nga auditimi rezulton se është likuiduar minimalisht vlera 1,334,308 USD, për këto punime të cilat dalin jashtë përdorimi, megjithatë nuk janë zbritur nga propozimi financiar për rindërtimin e Usekut të Mulletit.

Vlera 1,601,169.6 USD (1,334,308 USD+ TVSH) e cila është likuiduar për punime të cilat do të ribëhen konsiderohet dëm ekonomik, pasi ribërja e tyre ka ardhur si pasojë e defekteve të vlerësimit inxhinierik të realizuar nga vetë Kontraktori dhe duhet të kryhen me shpenzimet e kontraktorit (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, referuar Kontratës së punimeve civile “Ndërtimi i segmentit Sauk-Tunel i Krrabës”, të zbresë nga situacioni i pagesave të Kontraktorit “██████” vlerën 1,601,169.6 USD. Krahas zbritjes së kësaj vlere, të merren masa dhe të përlllogariten në detaje të gjitha punimet e realizuara në Usekun e Mulletit, të cilat janë shkatërruar si pasojë e ndryshimit të projektit, në përgjegjësinë e Kontraktorit.

Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve

2. Gjetje nga auditimi:

-Sipas situacionit nr. 16, janë likuiduar punime të përkohshme për marrje në dorëzim të pjesëve të rrugës, të cilat pretendohet se janë realizuar në muajin qershor 2013. Punimet konsistojnë në furnizim vendosje shenja trafiku të përkohshme, përbërës rrugorë dhe sinjalistikë horizontale e përkohshme. Në përshkrimin e urdhër ndryshimit nuk ka asnjë referencë ligjore, kontraktore apo akte të tjera. Ky urdhër ndryshimi është hartuar në muajin tetor 2015. Nuk është miratuar asnjë urdhër ndryshimi për realizimin e këtyre shërbimeve në periudhën e pretenduar si dhe nuk është certifikuar në periudhën e pretenduar si të realizuar. Menaxhimi i trafikut është pjesë përbërëse e kontratës dhe nuk likuidohet në vehte, pra përfshihet në zërat e tjerë të kontratës. Pas pretendimit të realizimit të këtyre punimeve janë realizuar 11 pagesa të tjera ku nuk është përfshirë asnjë pagesë për këtë qëllim.

Certifikimi për këto shërbime është në kundërshtim me Kushtet e përgjithshme të Kontratës Pika 4.8, Specifikimet Teknike të Kontratës Pika 1.03.4 dhe Pika 1.02.26. Vlera 179,047 USD (149,206.5 + TVSH) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

-Edhe sipas Urdhër ndryshimit nr. 8, është bërë likuidimi i vlerës 114,402.26 USD, për menaxhim trafiku për marrjen në dorëzim të përkohshëm të segmentit 3.

Me argumentimet e mësipërme vlera prej 137,282.6 USD (114,402 USD + TVSH) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, referuar Kontratës së punimeve civile “Ndërtimi i segmentit Sauk-Tunel i Krrabës”, të zbresë nga situacioni i pagesave të Kontraktorit “██████” vlerën 316,329 USD, vlerë e pa argumentuar, e pa justifikuar dhe përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.

Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve

3. Gjetje nga auditimi:

- Bazuar në certifikatën e punimeve nr. 15 (Kontrata nr. 1) për seksionin 14 + 850 deri tek hyrja e tunelit, për zërin e punimeve 260 “Furnizim vendosje guardrail tip H3”, është përfshirë furnizim vendosje guardrail në sasinë 2,588 ml, ndërkohë që nga verifikimi rezulton se në këtë segment është vendosur sasia 365 ml. Në certifikatën e pagesës nr. 16 është certifikuar sasia 530.8 ml. Ky veprim është në kundërshtim me Pikën 12.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës “Metoda e matjeve”.

Diferenca me vlerë 286,660 USD (2,223 ml x 107.46 USD/ml + TVSH), përbën punime të certifikuara, të likuiduara por të pa realizuara akoma (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit “██████” vlerën 286,660 USD, vlerë e likuiduar për punime të pa realizuara, përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.

Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve

4. Gjetje nga auditimi:

- Për segmentin nga kilometër 3+777 deri 5+744 është certifikuar sasia 11508 m² asfaltobeton dhe 18787 m² binder. Nga verifikimi dhe llogaritja e sipërfaqes për këtë segment rezulton se është shtruar gjatësia e rrugës 300 ml sipas projektit dhe gjatësia 150 ml për rrugën hyrëse. Nga përlllogaritjet rezulton se është certifikuar më tepër asfaltobeton në sasinë 4158 m² dhe binder në 3 shtresa në sasinë 12474 m². Pavarësisht se punimet për këtë segment nuk kanë përfunduar akoma, janë certifikuar punime të pa realizuara me vlerë 168,149.4 USD (140,124.5 + TVSH), përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit “██████” vlerën 168,149.4 USD, vlerë e likuiduar për punime të pa realizuara, përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.

Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve

5. Gjetje nga auditimi:

- Nga verifikimi i punimeve sipas zërit “Të mira publike”, Urdhër ndryshimi. Nr 7, konkretisht kryqëzimi i Mulletit, sifoni në kilometër 5 + 808 dhe kanali ujitës kilometër 6 +

250, u konstatua se ka diferenca të punimeve të certifikuara dhe likuiduara në krahasim me ato të realizuara si më poshtë:

Kryqëzimi i Mulletit.

Në distancën 10 ml, nuk është bërë veshja e tubit të betonit me beton C 16/20 sipas specifikimeve por është vendosur vetëm një pllakë në pjesën e sipërme. Betoni i certifikuar më tepër është në masën 14.9 m³. Nuk është bërë izolimi me bitum për sipërfaqen 1462.1 m². Kapakët e pusetave nuk janë bërë sipas specifikimeve, sipas të cilave duhet të vendoseshin me material metalik, ndërkohë që janë ndërtuar vetëm pllakë betoni.

Sifoni në kilometër 5 + 508.

Nga llogaritja e volumeve rezulton se nuk është zbritur sasia e betonit e cila rezulton si ndryshim i seksionit tërthor (zmadhimi i parapetit të tubit) në sasinë 55 m³. Po ashtu, në skica përcaktohet veshja me beton në gjerësinë 1.72 m, ndërkohë që nga verifikimi rezulton se kjo gjerësi është realizuar në masën 1.4 m (lartësia 1.72 m). Nga llogaritjet rezulton se është certifikuar më shumë beton në masën 30 m³.

Kanali ujitës në kilometër 6+000 deri në kilometër 6 + 250.

Si në rastin më sipër, në vend të tubacionit të përshkruar HDPE është vendosur tub betoni. Diferenca e betonit e përfshirë më tepër si rezultat i ndryshimit të spesorit është 53.2 m³. Në skica përcaktohet veshja e tubit me gjerësi 1.72 m, ndërkohë që është realizuar me gjerësi 1.4 m. Diferenca e betonit të përfshirë është në masën 133.2 m³. Nga verifikimi i pjesëve të dukshme, rezulton se nuk është realizuar izolimi me bitum në sasinë 1129.6 m². Nuk janë realizuar dy kapakë pusete të përshkruara të realizuara, por të pa nevojshme dhe të pa realizuara.

Ky veprim është në kundërshtim me Pikën 12.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

Sa më sipër, vlera 36,717.5 USD (30,597.9 + TVSH) e cila përfaqëson punime të likuiduara por të pa realizuara, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit "██████" vlerën 36,717.5 USD, vlerë e likuiduar për punime të pa realizuara, përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.

Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve

6. Gjetje nga auditimi:

-Sipas VO nr. 7 "Public Utilities" është likuiduar sasia 208 m² sinjalistikë horizontale, ndërkohë që nga auditimi në terren rezulton se ky vijëzim nuk është realizuar. Ky veprim është në kundërshtim me Pikën 12.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

Pagesa me vlerë 1,757.1 USD [(208 ml x 7.04 USD/m²) + TVSH], e cila përfaqëson likuidim të punimeve të pa realizuara të përfituara padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga situacioni i pagesave të Kontraktorit "██████" vlerën 1,757.1 USD, vlerë e likuiduar për punime të pa realizuara, përfituar padrejtësisht në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.

Gjatë hartimit të certifikatës së punimeve

7. Gjetje nga auditimi:

Në mënyrë të përmbledhur, nga auditimi u konstatua se Dega e Financës kryen pagesa fikse në vlerat tavan të përcaktuara në kontratën e lidhur mes palëve, duke mos marrë në konsideratë faturat tatimore të lëshuara, si dhe duke mos i bazuar këto shpenzime në dokumente mbështetëse justifikuese të detajuara, kjo kryesisht për rastin e shpenzimeve për shërbimin taksi, për të cilin është shpenzuar pa ekonomikitet vlera totale prej 15,000 USD (30 invoice x 500 USD). Për periudhën nën auditim nga Dega e Financës është paguar më tepër për qira ambientesh vlera totale prej 51,635 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Dega e Financës pranë ARRSH të marrë masa për zbritjen e vlerës prej 51,635 lekë të paguara më tepër për qira ambientesh, në situacionet e ardhshme të paraqitura nga Supervizori, si dhe në të ardhmen të kryejë transaksione të bazuara dhe vërtetuara me dokumentacion mbështetës, të cilat justifikojnë dhe përcaktojnë me detaje çdo shpenzimin, duke mos ndjekur rregullin e deritanishëm për të paguar në mënyrë konstante vlerën maksimale të lejuar në kushtet e kontratës për çdo zë, pavarësisht vlerës që paraqitet në faturën tatimore.

Menjëherë

C. SHPENZIME DHE TË ARDHURA JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT.

Gjatë auditimit është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve me vlerë **4,038,959 USD**, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

-Është miratuar nga Supervizori dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe është në pritje të miratimit të bankës, ndryshimi “Useku i Mulletit”.

Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i defekteve dhe mangësive të projektit origjinal, por edhe të vetë kontraktorit, sepse ky projekt është rishikuar nga vetë kontraktori nëpërmjet një **Vlerësimi inxhinierik** të miratuar.

Pas miratimit të vlerësimit inxhinierik dhe fillimit të punimeve sipas tij, ka rezultuar se ky vlerësim inxhinierik (projekt i rishikuar), është i mangët, kryesisht në zonën e Mulletit, ku skarpatat nuk kanë patur qëndrueshmëri. Për këtë arsye është propozuar të mos zbatohet vlerësimi inxhinierik, por të bëhet një urdhër ndryshimi duke paraqitur disa alternativa zgjidhjeje.

Bazuar në **vendimin e Këshillit Teknik nr. 46 (nr. Prot 5731, datë 02.07.2015)**, nuk janë pranuar alternativat e paraqitura, por është lënë që të vazhdohet me vlerësimin inxhinierik (projektin e rishikuar nga vetë kontraktori).

Bazuar në Urdhrin e Ministrisë nr. 110, datë 03.08.2015 është ngritur një Bord Drejtues, i cili pas shqyrtimit të dokumentacionit të projektit ka vendosur të pranojë një zgjidhje të paraqitur nga kontraktori e cila konsiston në një gjeometri të re të gjithë gjatësisë së Usekut të Mulletit, duke aplikuar pjerrësi më të buta për skarpatat. **Nga Bordi Drejtues i Projekti është sugjeruar Njesisë së Menaxhimit të Projektit që të instruktohet Kontraktori dhe Supervizori që të analizojnë çdo zë në preventiv dhe fazën e zbatimit të punimeve**, bazuar në gjendjen reale të vlerësojnë mundësinë e reduktimit të masave inxhinierike si dhe të **vlerësohet kontraktualisht përputhshmëria e zërit “Transport i materialit të gërmuar”, pasi ky zë është i përfshirë në preventivin origjinal.**

Këshillit Teknik i ARRSH është mbledhur me datë 23.02.2016, nga ku është miratuar Vendimi nr 10, me nr. Prot., 1440, datë 02.03.2016. Ky Urdhër ndryshimi nuk është miratuar përfundimisht. Vlera paraprake është 9,706,052.5 USD.

Në këtë vlerë është parashikuar vlera 1,980,000 USD për transport të dherave shtesë. Ky veprim bie në kundërshtim me Seksionin 4 të specifikimeve teknike të Kontratës.

Në pikën Pika 1.03.3, pikën 4.01 “Pastrime dhe shkulle”, pikën 4.7 “Gërmimet në përgjithësi” të Specifikimeve teknike të Kontratës.

Bazuar në përcaktimet e mësipërme të kontratës, përfshirja e një zëri të ri transporti me vlerë 1,980,000 USD, është i pa justifikuar dhe përbë përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve, pasi nuk ka marrë miratimet përfundimtare.

Pavarësisht se nga ana e KT është vendosur që të rishikohen masat inxhinierike si dhe çmimet përkatëse për çdo zë, preventivi përkatës është dërguar për miratim në Bankën Islamike për Zhvillim BIZH pa ndryshimet e kërkuara.

Në preventiv është përfshirë edhe vlera 350,000 USD për realizimin e projektit si dhe monitorimi gjeoteknik me vlerë 104,309 USD. Përfshirja e këtyre vlerave është e pa justifikuar, pasi vlerësimi inxhinierik është bërë nga vetë kontraktori dhe ka rezultuar i pa saktë. Sipas Pikës 13.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, në rastin e vlerësimit inxhinierik, ndryshimi i projektit duhet të bëhet me koston e Kontraktorit.

Në total, preventivit të punimeve për Usekun e Mulletit duhet t’i zbritet vlera 2,434,309 USD (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga preventivi përkatës i parashikuar për realizimin e punimeve në Usekun e Mulletit vlerën **2,434,309 USD**, vlerë e cila përfaqëson shtesë transporti, realizim vizatimesh dhe monitorimi gjeoteknik, parashikuar në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Nga ana e Supervizorit dhe e Njesisë së Menaxhimit të Projektit është miratuar edhe ndryshimi i projektit për rrëshqitjen e Ibës me vlerë 8,606,189.4 USD. Ky ndryshim nuk ka marrë miratimin përfundimtar nga BIZH.

Në vlerën e mësipërme është përfshirë shtesë transporti me vlerë 1,269,000 USD, në kundërshtim me Seksionin 4 të specifikimeve teknike të Kontratës, pikat 1.03.3 dhe 4.01 të Specifikimeve teknike.

Po ashtu është përfshirë vlera 250,000 USD për realizimin e vizatimeve dhe vlera 85,650 USD për monitorimin gjeoteknik, në kundërshtim me Pikën 13.2 të kushteve të përgjithshme të Kontratës “Vlerësimi inxhinierik”.

Në total, preventivit të punimeve për rrëshqitjen e Ibës i është përfshirë padrejtësisht dhe në kundërshtim me kontratën vlera 1,604,650 USD (trajtuar më hollësisht në faqet 36-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Supervizori, të zbresin nga preventivi përkatës i parashikuar për realizimin e punimeve në Rrëshqitjen e Ibës vlerën **1,604,650 USD**, vlerë e cila përfaqëson shtesë transporti, realizim vizatimesh dhe monitorimi gjeoteknik, parashikuar në kundërshtim me kontratën e punimeve civile.*

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në Udhëzuesin për Konsulencë, sipas financimeve të Bankës Islamike për Zhvillim pika 1.d dhe 1.17, i kërkojmë Autoritetit Rrugor Shqiptar:

Të shpallë të papranueshëm për lidhjen e kontratave për shërbime konsulence Shoqërinë “██████” dhe për punime civile kompanitë “██████” si dhe të marrë masa për njoftimin e Bankës Islamike për Zhvillim mbi performancën e dobët të këtyre kompanive gjatë zbatimit të kontratave të ndërtimit të segmenteve rrugorë “Sauk – Tuneli i Krrabës” dhe “Tuneli i Krrabës-Elbasan”, për arsye se zbatimi i kontratës së supervizionit dhe zbatimi i kontratave të punimeve civile, është shoqëruar me shkelje dhe mangësi si më poshtë:

- Sipas Urdhër ndryshimi nr. 6, janë certifikuar dhe likuiduar shërbime për menaxhim trafiku gjatë periudhës së inagurimit të punimeve, pa dokumentacionin përkatës justifikues, si dhe për shërbime të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës origjinale, duke vepruar në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 4.8, Specifikimet Teknike të Kontratës pika 1.03.4 dhe 1.02.26, duke shkaktuar dëm ekonomik me **vlerë 179,047 USD**.

- Sipas Urdhër ndryshimi nr. 8, janë certifikuar dhe likuiduar shërbime për menaxhim trafiku për marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve të segmentit “Tuneli i Krrabës-Elbasan pa dokumentacionin përkatës justifikues, si dhe për shërbime të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës origjinale, duke vepruar në kundërshtim me Kushtet e përgjithshme të Kontratës Pika 4.8, Specifikimet Teknike të Kontratës Pika 1.03.4 dhe Pika 1.02.26, duke shkaktuar dëm ekonomik me **vlerë 137,282.6 USD**. Referuar dokumentacionit të pagesës sipas këtij ndryshimi rezulton se krahas paligjshmërisë së likuidimit, nuk është përfshirë në likuidim vlera e miratuar nga Supervizori në shumën 114,402.26 USD, por propozimi i kontraktorit i cili është me vlerë 137,282.6 USD. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika (KPK) 14.10 dhe 14.11.

- Pavarësisht instruktimit nga Bordi Drejtues dhe Këshilli Teknik për analizimin e çdo zëri të punimeve për punimet në Kodrën e Mulletit, nga ana e Njësisë së Menaxhimit të Projektit dhe Supervizorit, është paraqitur për miratim pranë IDB preventivi i punimeve me vlerë 9,706,052.5 USD, i cili përmban disa zëra të punimeve në kundërshtim me kontratën, si dhe me vlerësimin inxhinierik të propozuar nga vetë kontraktori si më poshtë:

- Vlera 1,980,000 USD për transport të dherave shtesë, në kundërshtim me Seksionin 4 të specifikimeve teknike të Kontratës, pikën Pika 1.03.3 të Specifikimeve teknike të Kontratës “Kompensim për sasi të ndryshuara” dhe pikën 4.01 “Pastrime dhe shkulje” dhe pikën 4.7 “Gërmimet në përgjithësi”, nën-pika 4.07.6 “Hedhja e materialeve të zhvendosura”, të specifikimeve të Kontratës.

- Vlera 350,000 USD për realizimin e projektit, monitorimi gjeoteknik me vlerë 104,309 USD në kundërshtim me pikën 13.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC “Vlerësimi inxhinierik”

- Vlera 350,000 USD dhe rialokimi i shtyllave të tensionit të lartë, pa asnjë përlllogaritje.

Me të njëjtat shkelje kontraktore është vepruar edhe për Rrëshqitjen e Ibës, preventivi me vlerë 8,606,189.4 USD, i cili është dërguar për miratim në BIZH, pa analizuar çdo zë preventivi. Vlerat e përfshira në këtë preventiv në kundërshtim me kontratën, paraqiten si më poshtë:

- Vlera 1,269,000 USD për transport të dherave shtesë, në kundërshtim me Seksionin 4 të specifikimeve teknike të Kontratës, pikën Pika 1.03.3 të Specifikimeve teknike të Kontratës “Kompensim për sasi të ndryshuara” dhe pikën 4.01 “Pastrime dhe shkulje” dhe pikën 4.7 “Gërmimet në përgjithësi”, nën-pika 4.07.6 “Hedhja e materialeve të zhvendosura”, të specifikimeve të Kontratës.

- Vlera 250,000 USD për realizimin e projektit, monitorimi gjeoteknik me vlerë 85,650 USD në kundërshtim me pikën 13.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC “Vlerësimi inxhinierik”
- Vlera 200,000 USD dhe rialokimi i shtyllave të tensionit të lartë, pa asnjë përlllogaritje.
 - Nga verifikimi i punimet që po realizohen në Usekun e Mulletit sipas projektit të rishikuar rezulton se, punimet e realizuara sipas projektit origjinal janë shkatërruar si pasojë e vazhdimit të punimeve me ndryshimet e miratuara në projekt. Vlera e këtyre punimeve të cilat bëhen të pavlefshme (shkatërrohen nga realizimi i uljes së pjerrësisë së skarpateve) është (minimalisht) 1,334,308 USD, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Supervizori dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit nuk kanë marrë masa për zbritjen e kësaj vlere nga vlera e punimeve sipas projektit të rishikuar.
 - Nga verifikimi i disa zëra punimesh të kontratës së ndërtimit të segmentit “Sauk-Tuneli i Krrabës”, kanë rezultuar diferenca të punimeve të certifikuara dhe të likuiduara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlera si më poshtë:
 - Vlera 286,660 USD përfaqëson guardrail të pa vendosur por të certifikuar për seksionin 14 + 850 deri tek hyrja e tunelit.
 - Vlera 36,717.5 USD e cila përfaqëson punime të likuiduara për shtresa betoni izolim me bitum dhe kapakë pusetash, por të pa realizuara në masën e certifikuar, sipas urdhër ndryshimit nr. 7 “Të mira publike”, zëri 3.245 dhe 3.624.
 - Vlera 168,149.4 USD, për punime të certifikuara dhe të pa realizuara për shtresa asfaltme në kilometër 3+777 deri 5+744, në sasinë 11508 m² asfaltobeton dhe 18787 m² binder.
 - Vlera 1,757.1 USD, e cila përbën punime të certifikuara për realizim sinjalistike të cilat nuk janë realizuar akoma, sipas Urdhër ndryshimit nr. 7 “Të mira publike”, kryqëzimi i Mulletit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikën 12.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.
 - Nga auditimi rezulton se nuk janë marrë masat teknike për zbutjen e ndikimit në mjedis për gjithë segmentin rrugor Tiranë-Elbasan, si dhe problemet mjedisore në segmentin e parë, në zonën e Mulletit, kanë patur një ndikim negativ, në kundërshtim me pikën 3.1, paragrafi 3, të lejes mjedisore si dhe me Pikën 4.18 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës “Mbrojtja e mjedisit”.
 - Projekti në përgjithësi është menaxhuar dobët, pasi është shoqëruar me vonesa të shumta, ndryshime të theksuara dhe të rindryshuara, rritje të kostos së tij në mënyrë të konsiderueshme, monitorim i pa mjaftueshëm dhe pa cilësi si nga ana e Njesisë së Menaxhimit të Projektit ashtu dhe nga ana e Supervizorit.

E. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

a. “Largim nga detyra” për:

1. A.Q, në cilësinë e Drejtorit të Njesisë së Menaxhimit të Projektit, sepse:

- Sipas Urdhër ndryshimi nr. 6, ka certifikuar dhe likuiduar shërbime për menaxhim trafiku gjatë periudhës së inagurimit të punimeve, pa dokumentacionin përkatës justifikues, si dhe për shërbime të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës origjinale, duke vepruar në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 4.8, Specifikimet Teknike të Kontratës Pika 1.03.4 dhe Pika 1.02.26, duke shkaktuar dëm ekonomik me **vlerë 179,047 USD**.

- Sipas Urdhër ndryshimi nr. 8, janë certifikuar dhe likuiduar shërbime për menaxhim trafiku për marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve të segmentit “Tuneli i Krrabës-Elbasan pa

dokumentacionin përkatës justifikues, si dhe për shërbime të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës origjinale, duke vepruar në kundërshtim me Kushtet e përgjithshme të Kontratës Pika 4.8, Specifikimet Teknike të Kontratës Pika 1.03.4 dhe Pika 1.02.26, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **137,282.6 USD**. Referuar dokumentacionit të pagesës sipas këtij ndryshimi rezulton se krahas paligjshmërisë së likuidimit, nuk është përfshirë në likuidim vlera e miratuar nga Supervizori në shumën 114,402.26 USD, por propozimi i kontraktorit i cili është me vlerë 137,282.6 USD. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika (KPK) 14.10 dhe 14.11.

- Pavarësisht instruktimit nga Bordi Drejtues dhe Këshilli Teknik për analizimin e çdo zëri të punimeve për punimet në Kodrën e Mulletit, nga ana e Njesisë së Menaxhimit të Projektit dhe Supervizorit, është paraqitur për miratim pranë IDB preventivi i punimeve me vlerë 9,706,052.5 USD, i cili përmban disa zëra të punimeve në kundërshtim me kontratën, si dhe me vlerësimin inxhinierik të propozuar nga vetë kontraktori si më poshtë:

- Vlera 1,980,000 USD për transport të dherave shtesë, në kundërshtim me Seksionin 4 të specifikimeve teknike të Kontratës, pikën Pika 1.03.3 të Specifikimeve teknike të Kontratës “Kompensim për sasi të ndryshuara” dhe pikën 4.01 “Pastrime dhe shkulje” dhe pikën 4.7 “Gërmimet në përgjithësi”, nënpika 4.07.6 “Hedhja e materialeve të zhvendosura”, të specifikimeve të Kontratës.

- Vlera 350,000 USD për realizimin e projektit, monitorimi gjeoteknik me vlerë 104,309 USD në kundërshtim me pikën 13.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC “Vlerësimi inxhinierik”

- Vlera 350,000 USD dhe rialokimi i shtyllave të tensionit të lartë, pa asnjë përlogaritje.

Me të njëjtat shkelje kontraktore është vepruar edhe për Rrëshqitjen e Ibës, preventivi i me vlerë 8,606,189.4 USD, i cili është dërguar për miratim në BIZH, pa analizuar çdo zë preventivi. Vlerat e përfshira në këtë preventiv në kundërshtim me kontratën, paraqiten si më poshtë:

- Vlera 1,269,000 USD për transport të dherave shtesë, në kundërshtim me Seksionin 4 të specifikimeve teknike të Kontratës, pikën Pika 1.03.3 të Specifikimeve teknike të Kontratës “Kompensim për sasi të ndryshuara” dhe pikën 4.01 “Pastrime dhe shkulje” dhe pikën 4.7 “Gërmimet në përgjithësi”, nënpika 4.07.6 “Hedhja e materialeve të zhvendosura”, të specifikimeve të Kontratës.

- Vlera 250,000 USD për realizimin e projektit, monitorimi gjeoteknik me vlerë 85,650 USD në kundërshtim me pikën 13.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC “Vlerësimi inxhinierik”

- Vlera 200,000 USD dhe rialokimi i shtyllave të tensionit të lartë, pa asnjë përlogaritje.

- Nga verifikimi i punimet që po realizohen në Usekun e Mulletit sipas projektit të rishikuar rezulton se, punimet e realizuara sipas projektit origjinal janë shkatërruar si pasojë e vazhdimit të punimeve me ndryshimet e miratuara në projekt. Vlera e këtyre punimeve të cilat bëhen të pavlefshme (shkatërrohen nga realizimi i uljes së pjerrësisë së skarpateve) është (minimalisht) 1,601,169 USD (me TVSH), vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Supervizori dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit nuk kanë marrë masa për zbritjen e kësaj vlere nga vlera e punimeve sipas projektit të rishikuar.

- Nga auditimi rezulton se nuk janë marrë masat teknike për zbutjen e ndikimit në mjedis për gjithë segmentin rrugor Tiranë-Elbasan, si dhe problemet mjedisore në segmentin e parë, në zonën e Mulletit, kanë patur një ndikim negativ, në kundërshtim me pikën 3.1, paragrafi 3, të lejes mjedisore si dhe me Pikën 4.18 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës “Mbrojtja e mjedisit”.

- Projekti në përgjithësi është menaxhuar dobët, pasi është shoqëruar me vonesa të shumta, ndryshime të theksuara dhe të rindryshuara, rritje të kostos së tij në mënyrë të konsiderueshme, monitorim i pa mjaftueshëm dhe pa cilësi si nga ana e Njesisë së Menaxhimit të Projektit ashtu dhe nga ana e Supervizorit.

b. “Vërejtje për pushim nga puna”për:

1. E.K,

2. E.N, me detyrë inxhinierë pranë Njesisë së Menaxhimit të Projektit, sepse:

- Pavarësisht instruktimit nga Bordi Drejtues dhe Këshilli Teknik për analizimin e çdo zëri të punimeve për punimet në Kodrën e Mulletit, nga ana e Njesisë së Menaxhimit të Projektit dhe Supervizorit, është paraqitur për miratim pranë IDB preventivi i punimeve me vlerë 9,706,052.5 USD, i cili përmban disa zëra të punimeve në kundërshtim me kontratën, si dhe me vlerësimin inxhinierik të propozuar nga vetë kontraktori si më poshtë:

- Vlera 1,980,000 USD për transport të dherave shtesë, në kundërshtim me Seksionin 4 të specifikimeve teknike të Kontratës, pikën Pika 1.03.3 të Specifikimeve teknike të Kontratës “Kompensim për sasi të ndryshuara” dhe pikën 4.01 “Pastrime dhe shkulje” dhe pikën 4.7 “Gërmimet në përgjithësi”, nën-pika 4.07.6 “Hedhja e materialeve të zhvendosura”, të specifikimeve të Kontratës.

- Vlera 350,000 USD për realizimin e projektit, monitorimi gjeoteknik me vlerë 104,309 USD në kundërshtim me pikën 13.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC “Vlerësimi inxhinierik”

- Vlera 350,000 USD dhe rialokimi i shtyllave të tensionit të lartë, pa asnjë përlllogaritje.

Me të njëjtat shkelje kontraktore është vepruar edhe për Rrëshqitjen e Ibës, preventivi i me vlerë 8,606,189.4 USD, i cili është dërguar për miratim në BIZH, pa analizuar çdo zë preventivi. Vlerat e përfshira në këtë preventiv në kundërshtim me kontratën, paraqiten si më poshtë:

- Vlera 1,269,000 USD për transport të dherave shtesë, në kundërshtim me Seksionin 4 të specifikimeve teknike të Kontratës, pikën Pika 1.03.3 të Specifikimeve teknike të Kontratës “Kompensim për sasi të ndryshuara” dhe pikën 4.01 “Pastrime dhe shkulje” dhe pikën 4.7 “Gërmimet në përgjithësi”, nën-pika 4.07.6 “Hedhja e materialeve të zhvendosura”, të specifikimeve të Kontratës.

- Vlera 250,000 USD për realizimin e projektit, monitorimi gjeoteknik me vlerë 85,650 USD në kundërshtim me pikën 13.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës FIDIC “Vlerësimi inxhinierik”

- Vlera 200,000 USD dhe rialokimi i shtyllave të tensionit të lartë, pa asnjë përlllogaritje.

- Nga verifikimi i punimet që po realizohen në Usekun e Mulletit sipas projektit të rishikuar rezulton se, punimet e realizuara sipas projektit origjinal janë shkatërruar si pasojë e vazhdimit të punimeve me ndryshimet e miratuara në projekt. Vlera e këtyre punimeve të cilat bëhen të pavlefshme (shkatërrohen nga realizimi i uljes së pjerrësisë së skarpateve) është (minimalisht) 1,334,308 USD, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Supervizori dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit nuk kanë marrë masa për zbritjen e kësaj vlere nga vlera e punimeve sipas projektit të rishikuar.

- Nga auditimi rezulton se nuk janë marrë masat teknike për zbutjen e ndikimit në mjedis për gjithë segmentin rrugor Tiranë-Elbasan, si dhe problemet mjedisore në segmentin e parë, në zonën e Mulletit, kanë patur një ndikim negativ, në kundërshtim me pikën 3.1, paragrafi 3, të lejes mjedisore si dhe me Pikën 4.18 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës “Mbrojtja e mjedisit”.

- Projekti në përgjithësi është menaxhuar dobët, pasi është shoqëruar me vonesa të shumta, ndryshime të theksuara dhe të rindryshuara, rritje të kostos së tij në mënyrë të konsiderueshme, monitorim i pa mjaftueshëm dhe pa cilësi si nga ana e Njesisë së Menaxhimit të Projektit ashtu dhe nga ana e Supervizorit.

F. KALLZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e nenit 248 “Shpërdorimit të detyrës” bëjmë kallëzim penal për:

z. A.Q, me detyrë Drejtor i Njesisë së Menaxhimit të Projektit të Rrugës Tiranë-Elbasan”, (pa përjashtuar këtu edhe përgjegjësinë penale edhe ndaj eprorëve të tjerë të cilët kanë ndikuar me urdhërat e tyre si dhe personave të tjerë anëtarë të Njesisë së Menaxhimit të Projektit, që evidentohen më konkretisht në Raportin Përfundimtar të Auditimi), pasi nga auditimi rezultuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi të kryera me dashje, në dëm të interesave të ligjshme të shtetit dhe që përmbajnë elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal.

Shenim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R